



**GJKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR**

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 676/1607(31010-00462-83-2015)  
Dt. Rregj. 28.10.2015

Nr. Vendimi 273/1(208)  
Dt. Vendimi 30.05.2016

**V E N D I M**

**"NE EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 30.05.2016, ora 11.15 mori në shqyrtim kryesisht çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 676/1607(31010-00462-83-2015) datë 28.10.2015 me pale ndergjyqese:

**PADITËS:** Tatimpaguesi "Hasbije Gjuhca" identifikuar me NIPT L06727001D, me seli në Zues, pranë Urës së Bunës..

**TE PADITUR:** 1-Drejtorja Rajonale e Tatimore Shkodër.  
2-Drejtorja e Apelimit Tatimor-pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

**Me pjesmarrje te:** Avokaturës së shtetit.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr.6933 prot date 17.08.2015 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder dhe shfuqizim i vendimit nr.25314/I date 30.09.2015 i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

**BAZA LIGJORE:** Neni 17/a,7/a,15/a të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative, neni 31,32 e vijues i K.Pr.Civile , neni 109 i Ligjit Nr9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.Sh-se"i ndryshuar, udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjykata, kryesisht në mungesë të palëve ndërgjyqëse

**VËREN se:**

Paditesi Tatimpaguesi "Hasbije Gjuhca" identifikuar me NIPT L06727001D i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkoder me kërkesë padi kunder

- anes se paditur Drejtoria Rajonale e Tatimore Shkodër,dhe Drejtoria e Apelitit Tatimor
- pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë (me pjesë marrje të Avokates së shtetit) me objekt;

Shfuqizimi i aktit, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.6933 prot date 17.03.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizim i vendimit nr. 25314/I date 30.09.2015 i Drejtorisë se Apelitit Tatimor Tirane.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin e saj nr.273(208) dt.15.04.2016 ka vendosur:**

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelitit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë .

-Shpenzimet gjyqesore (në vlerën e taksës së padisë 3000 lekë) në ngarkim të palës së paditur.

-Ky vendim është i formës së prerë,perben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet ne menyre te menjehershme.

-Kunder vendimit nuk lejohet ankim.

Gjykata, kryesisht, në mungesë të palëve, konstaton se në dispozitivin e këtij vendimi nga ana e gjykatës është vendosur shfuqizimi i akteve administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.**38/31 prot datë 06.01.2015** të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.**2172/1 prot datë 19.03.2015** të Drejtorisë së Apelitit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë që nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi,pra nga ana e gjykatës (si rrjedhojë e veprimeve copy paste) është shënuar gabim numri i protokollit dhe datës së akteve administrative objekt gjykimi, ku në fakt rezultojnë të jenë aktet;

njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.**6933 prot date 17.08.2015** i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe vendimi nr.**25314/I date 30.09.2015** i Drejtorisë se Apelitit Tatimor Tirane

Në këto kushte Gjykata duhet të saktësoje në dispozitivin e këtij vendimi, aktet administrative (numrin e protokollit dhe datën e lëshimit të akteve administrative),

nga ajo e shënuar gabim:

Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.**38/31 prot datë 06.01.2015** të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.**2172/1 prot datë 19.03.2015** të Drejtorisë së Apelitit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë,

në atë të saktë:

Shfuqizimi i aktit, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.**6933 prot date 17.08.2015** i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizimin e vendimit nr **25314/I date 30.09.2015** të Drejtorisë se Apelitit Tatimor Tirane, prandaj,

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, konform nenit 312 te K.Pr.Civile

### **VENDOSI**

Korrigjimin e gabimit material në dispozitivin e vendimit 273(203) dt.15.04.2016 të ngrurit të protokollit dhe dates së akteve administrative

nga ajo e pasaktë:

- Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë

në atë të saktë:-

Shfuqizimi i aktit, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.6933 prot date 17.08.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizimin e vendimit nr.25314/I date 30.09.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Pjesët e tjera të vendimit mbetën ashtu siç janë.

Ky vendim i bashkëngjitet vendimit nr. 273(203) dt.15.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ti komunikohet ky vendim palëve ndërgjyqëse, palës paditese Tutimpaguesit "Hasbije Gjuhca", palëve të paditura; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, Drejtoria e Apelit Tatimor-pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë dhe Avokatures së Shtetit Shkodër.

Shkodër me date 30.05.2016

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



GJYQTARE

Valbona DURRAJ

